



Memorandum Mirëkuptimi

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është bërë më 11 shkurt 2022 ndërmjet Komunës së Hanit të Elezit dhe Organizatës Kosovare për Talent dhe Arsim - TOKA, duke synuar ofrimin e sa më shumë mundësive për të rinjtë e Komunës së Hanit të Elezit të zhvillojnë aftësitë e tyre përmes projekteve të ndryshme edukative që do të implementohen në vitin 2022-23.

Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

Komuna e Hanit të Elezit dhe Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim - TOKA, së bashku janë referuar në këtë dokument si "partnerë" dhe me këtë Memorandum Mirëkuptimi bien dakord për të filluar partneritet në zhvillimin e projekteve të edukimit joformal dhe Vullnetarizmit Edukativ, që do të mbështesin dhe përmirësojnë nxënien dhe aftësimin e rinisë së Komunës së Hanit të Elezit.

Përmes këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, partnerët bien dakord të bashkëpunojnë në zbatimin e projekteve të tilla përmes programit të Vullnetarizmit Edukativ (Klubeve të Super-Vullnetarëve dhe Super-Qytetarëve) dhe programeve tjera të edukimit jo-formal.

Përgjegjësitë e Palëve

Obligimet dhe përgjegjësitë specifike në përputhje me synimin e këtij Memorandumi janë:

Detyrimet e TOKAs

- Ofrimi i trajnimit të liderëve të Klubeve Super-Vullnetare dhe Klubeve Super-Qytetare, ofrimi i Kurrikulës së Vullnetarizmit Edukativ, mentorimi i vazhdueshëm i Liderëve gjatë vitit shkollor kur Klubi është aktiv, asistencë teknike dhe financiare për projektet e Klubit;
- Promovimi i punës së Klubeve dhe projekteve të tyre, duke përfshirë edhe materialin e gatshëm për Komunën që ta promovojë në rrjetet e saj mediale.
- Varësisht nga mundësitë buxhetore ofrimi i vizitave kulturore, mjedisore dhe kampeve verore për ngritjen e shkathtësive për të rinjtë e Klubit;
- Varësisht nga mundësitë buxhetore dhe meritave të Liderëve përkatës, ofrimi i mundësive për vizita studimore jashtë vendit për Liderët e Klubeve.

Detyrimet e Komunës së Hanit të Elezit

- Promovon dhe inkurajon shkollat relevante në Komunën e Hanit të Elezit, për të marrë pjesë në programet edukative të TOKAs;
- Promovon përmes mediave sociale punën e Klubeve të Vullnetarizmit Edukativ në Komunën e Hanit të Elezit;
- Viziton dhe promovon projektet e përfunduara të Klubeve të Vullnetarizmit Edukativ në Komunën e Hanit të Elezit;

- d) Ndanë mirënjohje për palët përkrahëse të projekteve të Vullnetarizmit Edukativ në Komunën e Hanit të Elezit, sipas propozimit të OJQ TOKA;
- e) Ndanë një buxhet vjetor prej 500 euro për përkrahjen e projekteve të Vullnetarizmit Edukativ në Komunën e Hanit të Elezit;
- f) Mbulon kostot e transportit dhe ushqimeve të lehta për vizitat kulturore dhe mjedisore për 50 Super-Vullnetarë në vit, me kosto maksimale 10 euro për person;
- g) Siguron dhe lehtëson procesin e marrjes së lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike për mbajtjen e takimeve javore të Klubeve të Vullnetarizmit Edukativ;
- h) Mbështetë në mënyra të tjera, sipas nevojës dhe mundësisë, Klubet dhe liderët e Klubeve të Vullnetarizmit Edukativ në Komunën e Hanit të Elezit.

Pajtueshmëria me ligjin

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të zbatohet në pajtueshmëri me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës. Ky Memorandum Mirëkuptimi mes palëve nënshkruese nuk duhet të bie ndesh me asnjë marrëveshje bashkëpunimi të bërë me palët e treta paraprakisht.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet, kontradiktat apo pretendimet e ngritura në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi do të zgjidhen përzemërsisht, përmes negociatave mes palëve nënshkruese.

Zgjatja, amendamenti

Palët mund të zgjasin apo të ndryshojnë këtë Memorandum Mirëkuptimi me pëlqim të ndërsjellë dhe në formë të shkruar.

Data e hyrjes në fuqi


Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Palët dhe do të ekzekutohet deri me 31 dhjetor 2023.

Hani i Elezit, 11 shkurt 2022

Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim - TOKA

Komuna e Hanit të Elezit

Jehona Gjurgjeala
Drejtoresha Ekzekutive



Mehmet Ballazhi
Kryetar

